



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore publike me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me situatën aktuale të fruthit në Shqipëri.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Klotilda Bushka, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla Nuri Belba, Floida Kërpaçi, Halim Kosova, Grida Shqina Duma, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

Mungojnë:

Bardh Spahia, Vangjel Tavo, Adelina Rista.

Të ftuar:

Merita Xhafaj - Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Silva Bino – Shefe e Departamentit në ISHP

Erol Çomo - Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor

Eduart Kakarriqi – përfaqësues i ISHP-së

Erida Nelaj - përfaqësuese e ISHP-së

Elona Kureta - përfaqësuese e ISHP-së

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen meqenëse plotësohet kuorumi.

Sot në rendin e ditës kemi një seancë dëgjimore me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me situatën aktuale të fruthit në Shqipëri. Arsyeja e kësaj kërkesë të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë lidhet pikërisht me këtë problematikë të rëndësishme të shëndetit publik. Kjo problematikë ka një kohështirje relativisht të gjatë, po kalon më shumë se një vit që vendi është nën një problematikë të tillë, shqetësime të herëpashershme janë ngritur lidhur me këtë çështje, ngjarje të caktuara, të karakterit shëndetësor, kanë ndodhur në vijimësi, qoftë të rinj të infektuar, qoftë konstatimi i disa problematikave që kishin të bënin me vaksinimin në të shkuarën, qoftë vdekjet që lidhen me fruthin. Pra, në tërësinë e tyre e bëjnë një problematikë, absolutisht, tepër serioze, flas kush di ta vlerësojë shëndetin publik në përgjithësi dhe pasojat që ka në popullatë, por edhe në sistem. Për fat të keq, shumë çështje, jo sot, por ndër vite, përqendrohen te dy elemente infrastrukture më shumë, një rikonstruksion më shumë apo më pak, ndërkohë që probleme të tilla, shumë të rëndësishme, kritike të shëndetit publik ose anashkalohen, ose lihen jashtë vëmendjes, ose zvarriten në kohë.

Pjesëmarrës në këtë dëgjese kemi zonjën Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjën Silva Bino, shefe departamenti në ISHP, zotin Erol Çomo, përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor, zonjën Erida Nelaj, përfaqësuese e ISHP-së, zonjën Elona Kureta, përfaqësuese e ISHP-së dhe zotin Eduart Kakarriqi, përfaqësues i ISHP-së.

Kam një pyetje të drejtpërdrejtë për ju, para se të shkojmë më poshtë.

Dje ne patëm të pranishme drejtoreshën e Institutit të Shëndetit Publik, po edhe drejtoresha kishte axhendë, që nuk mund të ishte këtu me ne?! Mirë ministria, zëvendësministri, sekretari i Përgjithshëm i ministrie, që është minimumi i komunikimit parlamentar, po as drejtori apo nëndrejtori i ISHP-së?! Unë e di që niveli i përfaqësimit është shumë i lartë dhe nuk mund të zbresë në nivelin parlamentar, por kaq, sepse drejtoresha erdhi dje për një çështje që edhe mund të mos vinte dhe nuk vjen sot, që ne po flasim për fruthin, drejtuesja e ISHP-së! Mbase kolegët më kuptojnë, sepse nuk është kaprico e imja. Në qoftë se nuk vijnë në këtë ditë, në institucionin më të lartë të vendit, i cili kërkon të informohet, ku do të shkojnë?! Do të shkojnë në ndonjë mbledhje, në ndonjë inaugurim, sepse nuk e kuptoj, kujt do t'ia japin këtë raport?! Ne këtu mund të ngremë probleme, që janë përtej mundësive të

karakterit organizativ, që shkojnë përtej mundësive të drejtuesve, të cilët, sigurisht, janë shtylla kurrizore e një institucioni, por institucioni ka edhe përgjegjësi administrative të larta, ndaj është i përfaqësuar në mënyrë të tillë. Nuk besoj se kam ndonjë koleg kundër për këtë çështje, sepse po ia pata kundër, edhe për këtë nuk jemi gjëkund. U bëmë shumë zemërgjerë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodi, mos u nxito, sepse do ta mbaroj këtë frazë deri në fund, pavarësisht nga shqetësimi yt.

Arritëm në mirëkuptimin mirë ministri dhe zëvendësministri, por jo në këtë nivel.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ki durim që ta mbaroj këtë frazë! Nuk mund të më ndërpresësh.

Çështja është shumë e thjeshtë: çfarëdo që të plotësosh, ka pasur mirëkuptim të plotë për nivelin politik. Unë nuk jam i predispozuar ta justifikoj, por duke parë dinamikën e punëve, nuk mund të shkohet deri në këtë derexhe! Kjo nuk është as për mua, as për ne të gjithë, është për ata që na dëgjojnë, që duan të marrin 5 informacione më shumë, të përjetojnë ndjeshmërinë e lartë shtetërore. Ne këtë gjë prandaj e bëjmë, për të përcjellë informacion. Po të duam i bëjmë të mbyllura mbledhjet, marrim 5 veta, bëjmë disa diskutime dhe e mbyllim, por ne duam që njerëzit ta ndiejnë veten sa më mirë, opinionin, sepse janë të shqetësuar. Ka gjëra që i dinë dhe ka gjëra që nuk i dinë, më pas duhet të jenë më të qetë, të dinë se si ndodh kjo situatë. Ne për ata e bëjmë, nuk e bëjmë për vete. Kjo është arsyeja, ndryshe jashtë këtij funksioni dëgjuesat nuk kanë pse të bëhen.

Klodiana Spahiu - Si pjesë e kryesisë së komisionit, edhe juve dhe zotit Spahia, ju kam kërkuar dje dhe pardje që të realizonim shtyrjen e kësaj seance dëgjimore, sepse ishte e pamundur nga përfaqësia e ministrisë dhe nga drejtoresha e Shëndetit Publik të ishin prezentë këtu. Nuk ramë dakord për këtë gjë, normalisht me Rregullore duhet t'i ktheheshim votimit në komision për shtyrjen e seancës dëgjimore.

Petrit Vasili – Pse duhet t'i ktheheshim votimit?

Klodiana Spahiu - Sepse, ishte kërkesë e vazhdueshme për një arsye objektive...

Petrit Vasili – Pse duhet t'i kthehemi votimit? Shpjegojeni.

Klodiana Spahiu - Nuk ramë dakord si kryesi bashkë.

Petrit Vasili – Kemi rënë dakord.

Që në datën 28 janar është njoftuar ministria me saktësi për të gjithë kalendarin e vendosur dhe nuk kemi pasur, qoftë dhe një *email* të vetëm, që nga data 28 janar, dhjetë ditë më parë, pas vendimit të përbashkët, jo timin, të dakordësuar për këtë çështje. Çfarë është komisioni parlamentar që një ditë më parë thoni sikur mos ta bëjmë nesër?! Në qoftë se do të

kishte rezerva, duhet të thuhej prandaj çohet njoftimi 10 ditë para, të thonin se për këto pamundësi objektive këtë aktivitet, të parashikuar 9 ditë më pas, pra të martën tjetër, ne kemi këto mundësi. Kjo është korrekte parlamentare, kjo është gjuha e komunikimit që di unë, e institucioneve me njëri-tjetrin, pra parlament me qeveri. Në qoftë se nuk ekziston kjo etikë komunikimi, atëherë jemi në nivel mizerabël. Ja ku e kemi datën 28, atë që kemi rënë dakord, jua kemi thënë bashkë. Nuk ka asnjë komunikim për pamundësinë e tyre. Ditën e fundit nuk mund të themi se ka një problem, pra sot për nesër! Unë distancohem nga kjo lloj mungese serioziteti.

Klodiana Spahiu - Unë kam për të shtuar, sepse dje në seancën dëgjimore ju e patë që ishte e gjithë ministria së bashku me specialistët.

Kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e ministrisë dhe ndoshta jo me shkrim, por e bërë ndaj meje, si nënkryetare e komisionit.

Petrit Vasili – Komisioni komunikon me...

Klodiana Spahiu - Komisioni ka një kryesi për të cilën ju kërkoja juve shtyrjen e seancës për arsye të mosparaqitjes, të mospjesëmarrjes së përfaqësuesit të ministrisë dhe drejtoreshës së Institutit.

Petrit Vasili – Ke marrë përsipër një detyrë të vështirë, që të bësh ca alibi që nuk të takojnë. Nuk janë as të tuat dhe nuk e kuptoj pse e keni marrë gjithë këtë mundim.

Klodiana Spahiu – Unë i mbahem fjalës që kemi diskutuar dje së bashku me nënkryetarin e komisionit. Nuk ramë dakord, tani ju keni të drejtën tuaj.

Petrit Vasili – Jo, nuk kam të drejtën time, por po them çfarë referuam. Fjalë për fjalë më thatë: nëse i mohon, mohoji, nuk e kam problem “Ministrja dhe zëvendësministrat e kanë të pamundur të marrin pjesë” dhe më thatë: “Zëvendësministrja ndodhet në Amerikë”.

Klodiana Spahiu – Po.

Petrit Vasili – Nuk ka gjë, ju thashë e bëjmë mbledhjen pa ministren dhe zëvendësministren. Nuk më thatë se nuk janë të tjerët. Më thuaj: a jam korrekt? Thuaj, zoti kryetar, po gënjen! Më thuaj, ku nuk them po të vërtetën?

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, unë nuk mbaj përgjegjësi për të gjithë punonjësit dhe përfaqësuesit që ka ministria.

Petrit Vasili – Më thuaj, a jam në rregull?

Klodiana Spahiu – Unë ju kërkoja që të bëjmë spostimin e seancës, nuk u realizua.

Petrit Vasili – Zonja Spahiu, dje kur u mbledhëm të tre, më thuaj këtë bisedë që po referoj, a po e them saktë, apo nuk po them të vërtetën?

Klodiana Spahiu - Po, shumë saktë po e thoni.

Petrit Vasili – Në rregull, vazhdojmë mbledhjen.

Edhe një herë tjetër lidhur me këtë gjë, sigurisht, ndiejmë keqardhje, pasi në vlerësimin tim, por edhe të komisionit një emergjencë e tillë kërkon demonstrimin më të lartë të asaj që quhet vlerësim shtetëror. Besoj se me pyetjet dhe me përgjigjet do të kemi edhe ndonjë ekspozitë të shkurtër, që mund ta bëjmë përpara, ku mund të shterojmë edhe pjesë të tjera.

Ka një detyrim të komisionit parlamentar, tek i cili bën pjesë edhe Ministria e Shëndetësisë, sepse nuk bën përjashtim nga të tjerat. Pra, komisionit i vihet përpara në dispozicion një material informativ, si për çdo temë të ditës, as për këtë nuk është depozituar një material informativ, që në teori do të ishte materiali më i lehtë në botë. Ky është detyrim parlamentar, nuk është kapriç e komisionit. Për çdo temë të ditës institucioni i thirrur për dëgjuesë, që është institucion shtetëror, vë në dispozicion informacionin përkatës. Përjashtim bëhet vetëm kur dëgjesa bëhet me organizma joqeveritarë, të cilët janë të lutur ta çojnë paraprakisht një informacion paraprak, por që mund ta paraqisni edhe në momentin e zhvillimit të dëgjuesës. Kështu që, edhe me këtë çështje unë konstatoj një nënvlerësim të pajustificuar ndaj komisionit, pasi ky është një detyrim dhe nuk kishte asnjë vështirësi, sepse ka 10 ditë që është njoftuar ministria dhe materialin mund ta depozitonte më parë. Është e para herë që ne zhvillojmë një seancë dëgjimore me një institucion shtetëror, i cili nuk vë në dispozicion informacionin. Pse duhet informacioni? Sepse kolegët duke pasur informacion, kanë mundësi ta studiojnë informacionin, të japin opinionet e tyre në mbështetje, të bëjnë vërejtje ose pyetje e të tjera. Sigurisht, kolegët që janë njohës të fushës janë më komodë, por vihen në kushte të pabarabarta kolegë, të cilët mund të kenë distancë nga fusha për arsye edhe të interesave profesionale të ndryshme që kanë e të tjera.

Besoj se këto janë një tërheqje vëmendjeje lidhur me seriozitetin e komunikimit me ministrinë, të cilës po i kërkojmë njëherë e përgjithmonë, atyre që janë përfaqësues zyrtarë të ministrisë në këtë mbledhje, të mos përsëritet më asnjëherë.

Kështu që për t'u kthyer qëllimit të dëgjuesës, ju lutem më një parashitje të shkurtër dhe të përmbledhur vetëm momentet, fillimi i deklaramit të gjendjes së epidemisë, kryesisht rastet, momentet kryesore të këshillimit dhe momenti aktual përfshirë edhe eventet më të mëdha. Sa është numri i të prekurve dhe numri i atyre që kanë humbur jetën, në qoftë se ka pasur?

Dy konsiderata, si projektohet e ardhmja e epidemisë, jo vetëm si mendoni ju, po ashtu Organizata Botërore e Shëndetësisë e orienton ecurinë e saj? Do t'ju lutesha që ky informacion të jetë shumë i përmbledhur dhe jo narrativ, por me shifra dhe fakte konkrete.

Kush e do fjalën nga të ftuarit?

Urdhëroni, zonja Bino!

Silva Bino – Në fakt, kur po vija këtu m'u kujtua se ne të dy bashkë 20 vjet më parë, kemi ardhur në këtë komision për të dhënë llogari pse po bënim vaksinimin masiv të fruthit.

Gjithsesi numri i prekurve është 1367, këto janë raste të konfirmuara dhe janë rreth 2700 raste të dyshuara. Pra, 1367 raste janë konfirmuar që kanë qenë raste me fruth. Nga këto raste, kemi pasur tri vdekje në vitin 2018 dhe një vdekje në janar të vitit 2019

Grupmosha më e prekur ka qenë ajo nën 2 vjeç dhe pastaj kemi pasur një grupmoshë, e cila ka qenë 16-20 vjeç, por shumë më pak e prekur. Rrethi më i prekur është Tirana. Kryesisht burim i infeksionit është Tirana për shkak të mbulesës së ulët të vaksinimit që ajo ka. Njëkohësisht, kur kemi bërë analizën e vitit 2018 rrethet më të prekura, përveç Tiranës, kanë qenë: Kukësi, Lezha, Durrësi dhe Vlora.

Dua të theksoj se qoftë në Tiranë, qoftë në Durrës, qoftë në Vlorë apo qoftë në Kukës kemi pasur edhe importim të rasteve. Pra, e gjithë kjo epidemi ka qenë e përfshirë, ku burimi i infeksionit ka qenë brenda vendit, ka qenë edhe me importim të rasteve, sepse duhet të kemi parasysh se situata e fruthit në rajonin europian është e paprecedentë në 2 vjetët e fundit. Pra, ka një rritje masive të numrit të rasteve dhe, natyrisht, kjo vjen nga ulja e mbulesës vaksinave. Pra, kjo ka qenë arsyeja për sa i përket fruthit në përgjithësi.

Pjesa më e madhe e fëmijëve, gati 80% e tyre, kanë qenë të shtruar në spital. Pra, format e tyre nuk kanë qenë për të shkuar në shtëpi. Kurse pjesa e të rriturve 40% janë shtruar në spital. Pra, format më të rënda i kemi pasur te fëmijët. Natyrisht, kjo është arsyeja që kemi pasur vdekje të shkaktuara nga pneumoniti, të cilat shkaktohen nga virusi i fruthit.

Për sa i përket të gjithë pikturës së fruthit, kuadrit të fruthit, në vendin tonë, kurba e epidemisë pikun e ka pasur në mars dhe në prill, më pas numri i rasteve ka ardhur duke u zvogëluar. Pothuajse në muajin gusht nuk kishim fare raste dhe patëm një ringritje të numrit të rasteve, e cila vazhdon në të njëjtat shifra edhe në fund të muajit nëntor dhedhjetor. Po ashtu, rastet me fruth kanë vazhduar edhe gjatë janarit dhe shkurt. Natyrisht, nuk është piku që kemi pasur, por janë raste që qarkullojnë. Rastet e fundit janë pothuajse 90% të lidhura me kujdesin spitalor në QSUT, pavarësisht apelit që është bërë, sepse këto janë të lidhura edhe me shpërthimin e gripit. Natyrisht, një pjesë e nënave shkojnë të gjitha në spital, në një kohë që ka 4 qendra shëndetësore, të cilat ofrojnë shërbim 24 orë. Ne kemi bërë apel që prindërit të shkojnë pranë poliklinikave dhe të mos dynden të gjithë në spital. Kjo ishte për sa i përket situatës së fruthit në vendin tonë në vija të përgjithshme.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Kam një pyetje: me të drejtë, për shkak të boshllëkut në vaksinim, i cili është konsideruar një nga fajtorët e këtij rishpërthimi, që Organizatat Botërore të Shëndetësisë e quan më të lartin në 10 vjetët e fundit, jo thjesht në 2 vjetët e fundit, në fakt, ky është qëndrimi zyrtar që ata kanë, sepse shkalla e përhapjes dhe vdekjet që ndodhën në rajon e imponon një gjë të tillë, edhe Ministria e Shëndetësisë e adaptoi këtë pozicion, që duhet të kemi një vaksinim më të gjerë për të mbyllur gepet e të tjera.

Parlamenti shqiptar ka pasur mundësi që në disa akte normative, brenda vitit, të shikojë spostimet e fondeve që qeveria kalon nga një ministri tek tjetra për të mbështetur situata të veçanta. Sigurisht, ne jemi këtu për të bërë kontrollin parlamentar edhe të fondeve, por nuk kam parë asnjë transferim dhe asnjë mobilizim fondi për blerjen ekstra të vaksinave. Besoj se këtu nuk kemi çfarë të kundërshtojmë, që kërkohej një sasi vaksinimi e jashtëzakonshme, sepse e zakonshmja është për të mbuluar atë që është vaksinimi rutinë. Sigurisht, në momente epidemie, është detyrim që të blesh vaksinë, në mënyrë që të gjitha fashat, të cilave ua këshillon si mjetin e domosdoshëm ta kenë këtë vaksinë. Unë nuk kam parë gjëkundi, as Ministria e Shëndetësisë nuk ka referuar në asnjë rast, i kam ndjekur të gjitha komunikimet që janë bërë se cilat kanë qenë sasia e fondeve të mobilizuara për përballimin e epidemisë me të gjitha zërat përkatëse, qofshin zëra për të blerë vaksinë shtesë, qoftë për të hapur pika të tjera, sepse kur bëhet fjalë për një epidemi që rikthehet, bëhet fjalë për një situatë të jashtëzakonshme.

Së dyti, sot e kësaj dite, megjithëse ju e dini detyrimin që ka rregullorja sanitare ndërkombëtare, të cilën e kemi në fuqi që në vitin 2010, por dhe jo vetëm, nuk ka një deklaram publik, ju e dini se çfarë do të thotë, “Ditën e deklaramit të gjendjes së epidemisë”. Kjo është një detyrim i rregullores. Sot e kësaj dite një moment i tillë nuk ekziston dhe ju e dini se ka dy kuptime, ka kuptimin e detyrimit zyrtar, pasi njeh popullatën me një çështje të tillë, njeh institucionet vendase me të gjithë bashkëpunimin që kanë.

Së treti, jep mundësinë që nga dita e shpalljes së epidemisë dhe deri në ditën e mbylljes së saj, që konsiderohet i mbyllur eventi epidemik, është e mundur të lexohet e gjithë shtrirja e rasteve dhe ecuria e tyre, çfarë u prodhuan dhe cilat ishin pasojat. Si e tillë, populli thotë është një situatë pa fillim dhe pa fund. Nuk është normale, pasi jo se e kërkojmë ne, por e kërkojnë të gjithë ato rregulla, të cilat të gjithë së bashku kemi miratuar, që nuk janë vetëm detyrim kombëtar, por për shkak të gjeografisë që rregullorja ka, është edhe detyrim ndërkombëtar. Unë fondet nuk i kam parë askund, që lidhen me çështjen. Pra, cilat janë sasitë e vaksinave ekstra të blera mbi të zakonshmen? Cilat janë arsyet që kanë penguar shpalljen publike të një epidemie? Nuk është se dua unë, por e ka rregullorja sanitare ndërkombëtare?

Silva Bino – Ju keni të drejtë. Organizata Botërore e Shëndetësisë është lajmëruar, sipas të gjitha rregullave për epideminë e gripit në Shqipëri. Kjo ka qenë edhe arsyeja që një grup ekspertësh i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në muajin shkurt të vitit që shkoi, të cilët na ndihmuan në lidhje me masat e marra.

Për sa u përket dozave të vaksinës, që janë shtesë, janë blerë 30 mijë doza vaksinim fruth-rubeolë, në flakon 10 dozash dhe janë blerë 30 mijë doza vaksinë fruth rubeolë parotit. Pra, janë blerë gati 60 mijë doza shtesë vaksinë jashtë programit të vaksinimit me një kosto 170 mijë dollarë. Kjo ka qenë vaksina ekstra që është blerë. E gjithë kjo pjesë e vaksinës është shfrytëzuar me 61000 vaksinime shtesë, të cilat janë kryer gjatë vitit që shkoi dhe gati 1500 vaksinime shtesë janë kryer gjatë muajit janar. Këto vaksinime shtesë kanë qenë kryesisht, sepse një nga strategjitë tona të kontrollit...

Fruthi është një sëmundje, e cila parandalohet vetëm kur mbulesa vaksinale është mbi 95% dhe fakt është që mbulesa në Tiranë ka rënë shumë dhe kjo është një situatë që ne po e diskutojmë dhe ka nevojë për një mbështetje të madhe jo vetëm nga ne, por nga publiku dhe ju këtu.

Petrit Vasili – Sa ka rënë mbulesa vaksinale?

Silva Bino – Mbulesa vaksinale ka rënë deri në 70%, që është një mbulesë tepër e ulët në zona të caktuara. Përhapja e rasteve të fruthit ka qenë arsyeja që ne kemi ndërruar strategjinë dhe e matim mbulesën vaksinale në çdo komunitet. Natyrisht, nuk është e lehtë që ta kryesh brenda Tiranës, por kjo ka qenë një nga strategjitë tona, që të matim mbulesën vaksinale në çdo komunitet dhe të ofrojmë vaksinimin tek personat, të cilët nuk janë mbuluar me dy doza apo që nuk janë vaksinuar në çdo komunitet.

Një nga strategjitë e përdorura ka qenë strategjia e kontrollit të kontakteve dhe e vaksinimit të tyre. Duke qenë se fruthi është një sëmundje tepër ngjitëse, natyrisht edhe kjo strategji nuk parandalon gjithçka, por epidemia e fruthit përfundon atëherë kur niveli i mbrojtjes vaksinale është mbi 95%. Sfida kryesore për ne është Tirana. Pse nuk ka më raste në Kukës? Rastet kryesore që ne kemi këtë vit janë të lidhura me Tiranën. Ne nuk kemi raste autoktone në rrethe në janar, por kemi në Tiranë.

Petrit Vasili – Para se të kalojmë më tutje, që mbulesa e vaksinimit në Tiranë të bjerë në 70%, dua t'ju them se jam i lumtur që nuk jam në drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë, sepse do të kishte qenë një ditë e zezë për të gjitha institucionet shëndetësore që të pranojnë që mbulesa e vaksinimit të bjerë në 70% në Tiranë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi se çfarë shpjegimi të bëjmë, sepse po flasin profesionistët, ku një fashë goxha e rëndësishme e mbulimit është jashtë kontrollit.

Silva Bino – Më fal, por dua të theksoj, që të mos kemi keqkuptime, se mbulesa e përgjithshme është 93%. Ne shkojmë në çdo komunitet, sepse nga këto komunitete shfaqet fruthi.

Petrit Vasili – Unë e kam shumë të qartë se çfarë do të ndodhë dhe nuk kam nevojë për këto sqarime. Problemi është shumë i thjeshtë, ju, siç e dini, gepet vaksinale kanë qenë një betejë jona për zona remote, të vështira, të izoluara e të tjerë, por që të kemi kaq shumë boshllëqe në Tiranë....

Silva Bino – Unë mund t’ju jap edhe arsyet.

Petrit Vasili – Nuk më duhen, më mjafton fakti. Praktikisht ka diçka që kurrë nuk është bërë publik ose nuk është ndarë me ne ky problem, sepse ne nuk mund të japim ndihmën tonë, kur askush nuk na vë në dispozicion shifra. Ne këtu dëgjojmë vetëm fjalët: “Për herë të parë, për herë të parë..”, por edhe kjo që thoni është një herë e parë, sepse 70% nuk kemi pasur asnjëherë.

Megjithatë, dua t’ju bëj edhe një pyetje tjetër. Cili ka qenë në total kontingjenti i të gjithë të vaksinuarve, të cilët rrezikoheshin për shkak të gepit vaksinal të krijuar gjatë viteve ‘90? Po të bëjmë një llogari shumë të thjeshtë, unë nuk dua t’i futem lapsit, por është një fashë shumë e madhe. Targeti është që të gjithë këta, 60000, të mbylleshin, në rast të kundërt potenciali i epidemisë për të qenë vërdallë mund të vazhdojë për vite me radhë dhe kjo mund të jetë një nga ato minat lëvizëse, që gjithmonë na përball me një problematikë. Opinioni duhet të dëgjojë për fashat në totalin e saj për 200 e ca mijë njerëz, është një target paraprak për të qenë relativisht të sigurt. Jemi 60000 dhe në momentin që vlerësohet si e tillë, gjëja e parë që duhet bërë është të mobilizoheshin 200000 vaksina për të bërë të mundur që epidemia të vihet nën kontroll, ose së paku të ishim në kufijtë e një epidemie të administrueshme.

Së dyti, bashkë me këtë duhet të kërkohej që të kishte një skemë shumë të lëvizshme, e cila do të evitonte... Ne kemi bërë shumë mirë që kemi krijuar të gjitha mundësitë që të bëhet *check up-i*, por ne bëjmë *check up* dhe nuk bëjmë vaksinim. Ky nuk është më shëndet publik, ky është më pak se hiç. Unë po flas për mbulimin e të gjithë kontingjentit që u vlerësua i rrezikuar për shkak të kësaj gjëje, sepse epidemia u pa si e tillë, nuk e bëtë vetëm ju vlerësimin, por e bënë edhe të tjerët. Shqiptarët u njohën me këtë epidemi dhe unë që jam rreth 45-50 vjeç kam këtë shkallë rrezikimi dhe duhet të shkoj të vaksinohem. Specialistët e shëndetit publik arritën në këtë konkluzion dhe shteti u vë në dispozicion vaksinën, qendrat lëvizëse dhe...

Klodiana Spahiu – Më fal, zoti kryetar, a mundem për procedurë?

Petrìt Vasili – Ta mbaroj fjalën time, sepse diskutimi është shumë profesional.

Klodiana Spahiu – Nëse ju mendoni se jeni njohës i fushës së epidemiologjisë dhe ne të tjerët në komision të rrimë ... Kemi 47 minuta që kemi filluar mbledhjen e komisionit dhe shikoni sa minuta keni folur ju. A do të bëjmë seancë dëgjimore me pyetjet që të na japësh fjalën edhe ne të tjerëve, apo do të bisedoni vetëm ju të dy?! Të ikim ne dhe bashkëbisedoni ju. Nëse doni që njerëzit ta marrin vesh sesi është situata, na lër edhe ne të bëjmë pyetje dhe të nderuarit të kthejnë përgjigjet.

Petrìt Vasili – Çfarë ju shqetësoi nga këto që po them unë?

Klodiana Spahiu – Nuk është dialog.

Petrìt Vasili – Kur nuk e përkthen njeri....

Klodiana Spahiu – Ju jeni njohës i mirë i fushës dhe është shumë mirë...

Petrìt Vasili – Zonja Bino...

Klodiana Spahiu – A të kthehemi në rrjedhën normale dhe të bëjmë pyetjet?

Petrìt Vasili – Lëre këtë zhurmë.

Klodiana Spahiu – Çfarë zhurme, o doktor?!

Petrìt Vasili – Ne po ndajmë disa opinione...

Klodiana Spahiu – Nuk është normale që të ndajmë opinionet dhe të mos i marrin vesh njerëzit.

Petrìt Vasili – Nëse nuk i merr vesh ti, i kupton opinioni.

Klodiana Spahiu – Nuk i kuptoj unë dhe i kupton opinioni? Çfarë po thoni, o doktor?! Ju jeni kryetari i komisionit që të hapni seancën dhe kolegët të bëjnë pyetjet.

Petrìt Vasili – Ky është debat kot.

Klodiana Spahiu – Nuk është debat, por hajdeni të kthehemi në rrjedhën normale.

Petrìt Vasili – Po qeshin ata.

Klodiana Spahiu – Kush po qesh?

Petrìt Vasili – Ne po diskutojmë si është shpërndarë...

Klodiana Spahiu – Duhet ta marrim vesh edhe ne se çfarë po diskutoni.

Petrìt Vasili – Çfarë vërejtje keni për ato që them unë?

Klodiana Spahiu – Ju, si drejtues i komisionit, duhet të mblidhni pyetjet, t'ua dërgoni të ftuarve dhe ata të japin përgjigjet.

A mund të bëjmë ne ndonjë pyetje apo do të vazhdoni me komentet e përgjigjes së pyetjeve? Ideja e kësaj dëgjese është që të mblidhen pyetjet dhe përfaqësuesit të japin përgjigje.

Petrìt Vasili – Do t'i bëj të gjitha pyetjet, çfarëdo zhurme të bësh ti këtu.

Klodiana Spahiu – Unë jam shumë e nderuar që ju jeni njohës i fushës, por hajdeni..

Petrit Vasili – Mua nuk më duhet fare kjo, edhe si qytetar do t'i bëj pyetjet dhe do t'i marr përgjigjet.

Klodiana Spahiu – Hajde t'i bëjmë të gjithë pyetjet që t'i marrim vesh edhe ne.

Petrit Vasili – Nuk të lë ti, sepse po bën zhurmë.

Klodiana Spahiu – Po bëj zhurmë unë?!

Petrit Vasili – Ti nuk po më lë, sepse po them që janë 60000, si thoni për 20000, ti më thua pse bën pyetje.

Klodiana Spahiu – Ju dolët te *check-up*-i, por ne po flasim për situatën e fruthit.

Petrit Vasili – Unë thashë se si mundet që i njëjti mekanizëm lëvizës mund të përdoret edhe për vaksinat.

Klodiana Spahiu – Meqenëse ju, kryetar, folët 47 minuta, a mundet të kem 1 minutë kohë të bëj një pyetje?

Petrit Vasili – Nuk ka lidhje me 47 minutëshin. Të marrim përgjigjet dhe mos u mërzit.

Klodiana Spahiu – Çfarë përgjigjesh, që t'i marrim vesh edhe ne, sepse po i komentoni ju dhe nuk po kuptojmë asgjë.

Petrit Vasili - Le të jap përgjigjen zoti Kakarriqi. Përmbahuni se ky është një eksitim i kotë.

Klodiana Spahiu – Nuk është i kotë, sepse duruam gjatë gjithë kësaj kohe dhe vjen një moment që duhet..

Petrit Vasili – A ju mërzit informacioni shkencor?

Klodiana Spahiu – Cili është informacioni që ta marrim vesh?

Petrit Vasili – Ti ose nuk je e vëmendshme, ose nuk e kupton, por në të dyja rastet është keq.

Zoti Kakarriqi, fjala për ju.

Eduard Kakarriqi – Në qoftë se Silva tha që situata është e tillë dhe mbulesa është rreth 70%, e kishte fjalën për mbulesën në disa komunitete të caktuara të vogla, ndërkohë që në nivel vendi mbulesa vaksinore kundrejt fruthit apo sikundër të gjitha sëmundjeve të tjera infektive të parandalueshme me vaksinim është adekuate. Këtë e vërtetoj me një fakt, që nga dhjetori i vitit 2017 dhe deri në momentin që flasim tani ne në vendin tonë kemi jo më tepër se 1400 raste fruthi, që do të thotë 5 raste për 10 mijë banorë, insidenca është jashtëzakonisht e ulët, duke pasur parasysh që mbi 80% e popullatës prej 2 milionë e 800 mijë banorë të vendit tonë janë me mbrojtje pasvaksinore kundrejt fruthit, ky është momenti i parë.

Momenti i dytë, të cilin e vuri në dukje edhe ecuria e vet fruthit, duke filluar që nga dhjetori i vitit 2017, është prekja e foshnjave nën 1 vjeç, domethënë mbrojtja joadekuate e mbrojtjes mëmësore nga nëna transplacentare të këto foshnja, sepse në vendin tonë në vitet 1970-1980 mosha e vaksinimit kundër fruthit, që ka qenë një dozë, ka qenë mosha 9 muaj, por CRCA-ja me studimet e saj tregoi se jo vetëm në vendin tonë, por në të gjitha vendet, antikorpet anësore mund të jenë të pranishme deri në moshën 11-12 muaj, rrjedhimisht të afta për të neutralizuar virusin vaksinor të fruthit. Rrjedhimisht, vaksinimi kundër fruthit duhet të fillojë jo në 9 muaj, por në 12 muaj. Arsyeja pse ne e filluam vaksinimin në 12 muaj është nga fakti se mbi 70% apo 80% e nënave të fëmijëve me fruth kanë mbrojtje pasvaksinore kundrejt fruthit, jo pasinfeksioze, ku thuhet se këto nëna në vetvete janë të mbrojtura, por mbrojtja apo imuniteti transplacentar, që u transmetojnë foshnjave të tyre, inutero, është i tillë që ka një dobësim në muajt e parë shumë më shpejt sesa nëna të kishte mbrojtje pasinfeksioze kundrejt fruthit. Kjo është arsyeja pse ne kemi pasur raste me fruth dhe në moshat 4,5,6,7, e të tjerë. Në këtë kuadër, unë mund të them se në gjithë numrin e të sëmurëve me fruth një pjesë jo të vogël zënë pikërisht foshnjat nën 1 vjeç, si dhe foshnjat nën 2 dhe 3 vjeç, që kanë mbetur të pavaksinuar kundrejt fruthit për arsye krejtësisht subjektive, nga mosdëshira e nënave për të vaksinuar fëmijët nga frika e problemeve të autizmit e të tjera. Me gjithë thirrjet tona për problemin në fjalë, përsëri gjendja ka mbetur e tillë. Duhej të dilnin rastet e fëmijëve me fruth të prekur në moshën nën 12 muaj, por edhe 13 muaj, 15 muaj, 20 muaj dhe më tej që të bëhej dyndje e prindërve për të vaksinuar fëmijët me fruth. U iku frika nga autizmi dhe u erdhi nga fruthi.

Unë dua t'ju them se ne në vendimin që kemi marrë si komitet ekspertësh kundrejt fruthit dhe që ia transmetuan ministrisë ka qenë fillimi i vaksinimit kundrejt fruthit përsëri në moshën 9 muaj, nxitja e nënave për të vaksinuar fëmijët në moshën 9 muaj ose 12 muaj dhe vaksinimi i të gjitha kontakteve, qofshin këta familjarë, në kopshte, në çerdhe, në shkolla, në punë e të tjera, vaksinimi i të gjithë personelit shëndetësor mjekësor, pavarësisht nga mosha, dhe nga ana tjetër, thirrje e të gjithë individëve të datëlindjeve mbi vitin 1980, të cilët nuk kanë marrë dy doza vaksinim fruthi, për të bërë vullnetarisht vaksinimin kundrejt fruthit. Pyetjes se sa vaksinë parashikohet, duhet më tepër se sa vaksina që vjen është: jo më shumë se 60, 70, 80, 90 dhe 100 mijë doza fruth rubeolë, e cila nuk skadon, sepse aplikohet te fëmijët e moshës 5 vjeç dhe 6 vjeç. Kjo ishte përgjigjja ime lidhur me problemin e situatës aktuale të fruthit.

Faleminderit!

Petrit Vasili –Zonja Spahiu, fjala për ju.

Klodiana Spahiu – Përshëndetje!

Unë kam pyetje lidhur me një informacion më të detajuar. Cila është situata e vaksinimit e raportuar nga drejtoritë rajonale të shëndetit publik? Cila është situata jashtë rutinës dhe problematikës së asaj që thatë në lidhje me frikën e prindërve për të vaksinuar fëmijët, që mendohej se ka origjinën autizmi? Unë nuk e di që nuk ka një bazë shkencore për këtë dhe ky duhet të jetë një apel dhe mesazh për prindërit që të mos mbahen në këtë origjinë të autizmit, sepse nuk është e vërtetë një gjë e tillë. A mundeni të na bëni një raportim jashtë rutinës, ku mendoj se përfshihen edhe komunitetet që përmendi doktoreshë Silva. Cila është situata në komunitetet e caktuara, të cilat janë më problematike?

Faleminderit!

Silva Bino - Vaksinimet jashtë rutinës kanë qenë 61000 në vitin që shkoi dhe rreth 1500 vetëm gjatë muajit janar të këtij viti. Pra, kemi një rritje të numrit të vaksinimit. Nga këto 61000 vaksinime rutinë kanë qenë fëmijë të pavaksinuar më parë dhe janë kapur gjatë kontrollit derë më derë, kanë qenë vaksinime në moshe të rritur, të cilët kanë pasur një dozë, ku gati 36 mijë kanë qenë të tilla. shihet se numri i vaksinimeve në moshë të rritur është më i madh sesa ai i vaksinimeve me dy doza në moshë të vogël, kjo për shkak të prindërve. Në Shqipëri frika nga autizmi është futur më vonë dhe televizionet italiane, të cilat bëjnë një luftë të madhe kundër vaksinës, kanë infektuar edhe vendin tonë. Vaksinime janë kryer në komunitetin rom për rreth 1400 vaksinime dhe rreth 10000 vaksinime të personat e kontaktit. Pra, si e tha edhe Edi, ata kanë qenë persona në çerdhe, kopshte në punë, ku në Durrës është vaksinuar një ndërmarrje me punonjës, apo vaksinime të kontakteve lidhur me rastet e importuara, sepse në qytetin e Vlorës i gjithë shpërthimi ishte nga rastet e importuara. Të gjitha këto kanë qenë vaksinime të kryera.

Për sa i përket autizmit, është e vërtetë që vitet e fundit ka një frikë midis lidhjes së vaksinës së fruthit dhe autizmit, por, pavarësisht nga kjo, ne kemi bërë takime me mjekët e konsultoreve dhe mjekët peditarë për t'u shpjeguar pse vakcina e fruthit nuk shkakton autizëm. Kjo vaksinë nuk shkakton autizëm, sepse nuk ka asnjë bazë shkencore. Këtë nuk e themi se nuk ka bazë, por se personi i cili mendoj se vakcina e fruthit shkakton autizëm mendonte se nëpërmjet fruthit shkaktohen disa peptide, të cilët kalojnë **zorën** dhe nga zora kalojnë cipën e trurit dhe futen aty. Ky ishte argumenti i mjekut, që lidhi autizmin me vaksinën e fruthit, por është një studim që është tërhequr edhe nga revista *Lancet* dhe një gjurmim që është bërë nga gazetarët e *British Medical Journal*. Pra, e gjithë kjo është një mashtrim, i cili ka qenë i lidhur me grupet antivaksinë. Me të gjitha këto argumentet dhe disa të tjera, të cilat lidhen me mënyrën sesi prodhohen vaksinat, jemi përpjekur t'ua shpjegojmë mjekëve të konsultoreve, të familjes,

pediatërve dhe mjekëve të përgjithshëm në mënyrë që ata të shpenzojnë më tepër kohë për të diskutuar me nënat.

Natyrisht që kjo ka nevojë për një fushatë më të madhe komunikimi dhe ne jemi në këtë proces, ku jemi duke punuar për këtë fushatë dhe për këtë na duhet edhe ndihma juaj.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Zonja Duma, fjala për ju.

Grida Shqina Duma – Për një saktësim, në emër të etikës së atyre që na dëgjojnë përtej kësaj sale, kjo mbledhje filloi në orën 10:30, për shkak se duhet të mbledhesh kuorumi, prezenca e kolegëve të maxhorancës. Nuk kishte asnjë problem që pritëm, por problemi është që të jemi të saktë në mënyrën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka asnjë rëndësi nëse jemi të gjithë apo jo, kuorumi është një gjë tjetër. Ndoshta do të kishim pritur, si ta vendoste kryetari i komisionit, edhe 50 minuta. Nuk kishim asnjë lloj problemi në këtë kuptim. Për t'u sqaruar është fakti se kemi 30 minuta që kemi nisur seancën, ku problematika është shtruar siç e gjykon ai që e drejton seancën. Të mbronin një rezultat të mirë, ndërkohë që realiteti nuk është i mirë, sidomos për ju që jeni mjekë, nuk është humane. Pra, të mos merremi me kush, si dhe qysh e bëjmë debatin, por të merremi me atë se çfarë prodhojmë dhe a kemi rezultat të njerëzishëm, të shëndetësia, të fëmijët, të nënat etj. Roli ynë është të kontrollojmë dhe të monitorojmë dhe, nëse mundemi, të parandalojmë, sepse ky është i gjithë thelbi i diskutimit. Diskutimi për këtë sëmundje, deri diku është i thjeshtë, nuk është i nivelit të lartë profesional. Është e qartë që strategji kërkon parandalimin e situatës.

Pa dyshim që nuk është profesionale që zotëria të thotë se numri i vaksinave shkon nga 60-70-80-90, se diferenca midis 60-90-100 është 40%. Nëse duam të jemi profesionistë, duhet të dimë saktësisht se sa janë dhe jo të lëvizim në përqindje, sepse janë jetë njerëzore, foshnjash, fëmijësh dhe nënash dhe nuk jemi këtu duke folur këtu për tonelata produktesh industriale. Në këtë kuptim, duhet të përmenden shifra të sakta dhe të dihet më parë e saktë dhe jo të dihet më pas, sepse, në qoftë se dimë më mbrapa, kemi humbur jetë njerëzish.

Flasim për panoramën e përgjithshme. Çdo njeri që dëshiron të lexojë dy gjëra, shikon se sa është parandaluar kjo me sensibilizimin e popullatës. Shikoni sot dhe konfirmojeni se sa sensibilizim i keni bërë ju situatës për nënat që kanë lindur në vitet '70-'80 dhe sa dinë ato për këtë çështje apo për çdo qytetar tjetër, i cili nuk ka dijeni, ose nuk mban mend. Cila është mënyra që mund të bëhet ky sensibilizim? Në qoftë se ju më thoni sot se keni folur me mjekët, atëherë jemi në varësi të atyre që shkojnë te dera e mjekut.

Silva Bino – Unë fola për një pjesë.

Grida Shqina Duma – Unë citova atë që thatë ju.

Silva Bino – Ju nuk pyetët. Pyesni, sepse te gjërat e thjeshta qëndron i gjithë thelbi. Edhe Kolombi ashtu e zbuloi vezën.

Grida Shqina Duma – Zonja Bino, ju siguroj se metaforat i konsumoj më mirë se ju, dhe këtu po mbaj racionalen, të jeni e sigurt ju dhe të gjithë. Ju siguroj se i ndaj më mirë se ju se çfarë ka thënë Kolombi për vezën dhe si rri në këmbë, çështja është që jetët njerëzore të mos jenë të shtrira. Prandaj, ju lutem, mos ndërhyuni, sepse unë ju dëgjova dhe është pjesë e etikës në çdo moment.

Siç e tha kryetari i komisionit, nuk ka ngjarë ndonjëherë që të hyhet në komision pa asnjë material të përmbledhur. Kjo tregon jo vetëm mungesë profesionale, por edhe mungesë përgjegjësie. Në qoftë se nuk i lini shifrat këtu, por dalin vetëm në medie, do të thotë se nuk doni të mbani përgjegjësi dhe jo vetëm që nuk jeni të paaftë. Unë ju flas për aftësi apo për paaftësi profesionale, por ju flas, së pari, për paaftësi institucionale, pra për mbajtjen e përgjegjësisë.

Së dyti, ju thoni, përsëri po ju citoj ju, se një pjesë e shkakut është se nënat me fëmijë shkojnë në spitale dhe jo në qendrat e tjera spitalore, pra se kemi edhe katër qendra të tjera. Çfarë do të thotë kjo “u themi, por ato vijnë”? A ka protokoll parandalues? Nëse ju thoni se ka, shqiptarët kanë parë se nuk ka, sepse në kronikat e një prej televizioneve më të mëdha kombëtare kemi parë prindër, të cilët para mikrofonit thonë: “Nuk kemi çfarë të bëjmë, këtu do të vijmë. E dimë që mund të kemi, sepse jemi shumë rëndë me grip, dhe vijmë këtu te fruthi”. Mund t’ju jap unë me video se si shprehen prindërit. Në qoftë se ju thoni se ka, duhet ta mbani ju këtë përgjegjësi, sepse në realitet ndodh ndryshe. Në realitet ndodh që prindi shkon me fëmijën me grip i qartës se mund ta marrë sëmundjen ngjithëse të fruthit aty brenda. Në qoftë se ka protokoll, ky protokoll nuk është thjesht ta lajmëroni në medie “mos hajdeni këtu, se këtu mund t’ju ngjitet fruthi”, por është ndalesë fizike: “Nuk keni për të hyrë”. Ky është protokoll mjekësor. Nuk është protokoll mjekësor të thuhet që ka dhe që e dimë se ngjitet, pra që është një pjesë e situatës.

Ju thatë se keni blerë rreth 30 mijë vaksina me flakonë 10-she...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, janë 3 mijë jo 30 mijë dhe janë vaksinuar 61 mijë? Kanë mbaruar vaksinat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, keni vaksina të tjera. Keni porositur, pra ju thoni se ka gjendje shtesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të na e depozitoni më pas. Pra, ju keni porositur vaksina shtesë, ndërkohë që keni pasur gjendje, që ta kuptojmë këtë?

Silva Bino – Për ta kuptuar: ne bëmë një parashikim për rreth 100 mijë doza vaksinash, të cilat duheshin për të vaksinuar gepet kryesore. Nga ky parashikim ne blemë 60 mijë dozat, dozat e tjera janë duke u blerë.

Grida Shqina Duma – Janë duke u blerë, ndërkohë që keni gjendje?

Silva Bino – Kemi porositur. Kemi gjendje në të gjitha DSHP-të. Natyrisht që kemi gjendje.

Grida Shqina Duma – Ju thoni se po blini shtesë, prandaj ju pyeta.

Silva Bino – Po blejmë shtesë për të qenë të përgatitur për të vaksinuar të gjitha gepet...

Grida Shqina Duma – Sa është numri i nënave që kanë lindur në atë grupmoshë që thoni ju, pra në atë periudhë që thoni ju se janë të rrezikuara?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po ju pyes me kategori, sepse kur të shkoni të bëni komunikimin, nuk do të flisni në turmë, nuk do të bëni fushatë elektorale. Kur ju bëni parashikimin për vaksinat për 60-70-80-90, e bëni atë duke parashikuar se sa janë nëna, sa fëmijë etj. Po e filloj diskutimin dhe po ju pyes: sa nëna janë; sa fëmijë janë? A mund të na i jepni këto shifra, meqenëse nuk na e keni dhënë materialin? E dini ju se sa janë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

40 mijë nëna, nga të cilat?

Silva Bino – Nga të cilat 25 mijë janë vaksinuar.

Grida Shqina Duma – Domethënë, mbeten edhe 15 mijë të pavaksinuara.

Silva Bino – Mbeten edhe 15 mijë të tjera, të cilat janë hipotetike, sepse në mbulimin vaksinal nuk ka asgjë me saktësi.

Grida Shqina Duma – Jo, në mbulesën vaksinale edhe 25 mijë i bie që nuk duhej të ishin vaksinuar.

Silva Bino – Jo, duhej të ishin vaksinuar, sepse ashtu matet.

Grida Shqina Duma – Është i njëjti target grup.

Silva Bino – Pra, mbetet edhe ky grup, i cili është duke u vaksinuar. Po vazhdon.

Grida Shqina Duma – Pra, ju po thoni se janë ende edhe 15 mijë nëna. Po fëmijë sa janë?

Silva Bino – Absolutisht po. Fëmijë janë rreth 10 mijë fëmijë.

Grida Shqina Duma – Me këto rrumbullakosje do të flasim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po jua thoni qytetarëve shqiptarë me “gati-gati”. Të ktheheni mbrapsht dhe të llogarisni 30%, unë e kuptoj këtë gjë, por nuk jemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju e llogarisni aq mirë, sa keni sot rreth 1367-1400 raste me fruth dhe e quani këtë një arritje, sepse është 1 në 5! Ju këtë koncept të së mirës keni ju dhe unë këtë koncept të së mirës jam duke diskutuar me ju.

Mertia Xhafaj – Zoti kryetar, a ka mundësi, ju lutem?

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – Zonja Bino, nuk është pazar. E ka kërkuar fjalën zonja Xhafaj.

Urdhëro, zonja Xhafaj!

Merita Xhafaj – Shumë faleminderit për ftesën dhe për seancën dëgjimore të komisionit!

Ndihemi vërtet të vlerësuar të ndajmë së bashku një informacion për situatën aktuale të fruthit.

Së pari, më lejoni të kërkoj ndjesë që nuk është e pranishme drejtoresha e Institutit të Shëndetit Publik, por, natyrisht, në të njëjtin nivel jam unë, sepse të dyja jemi drejtoresha të përgjithshme dhe kam të gjithë përgjegjësinë dhe kompetencën për të dhënë këtu informacionin e kërkuar nga ju.

Fillimisht e morën fjalën doktoreshë Bino dhe profesor Kakarriqi për shkak se ata janë profesionistë dhe ekspertë të fushës, por nga pikëpamja e politikëbërjes dhe e situatës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale ka disa struktura, të cilat mbulojnë jo vetëm raportimin dhe analizën e situatave të epidemive, por edhe masat e rekomandimet që duhet të jepen për të parandaluar situata të tilla apo për t’u ardhur në ndihmë atyre që janë të infektuar.

Rastet e para të identifikuara janë vënë re në vitin e kaluar, sikurse tha edhe doktoreshë Bino. Lidhur me takimet e komiteteve që janë ngritur brenda strukturave të ministrisë, është një komitet ekspertësh që drejtohet nga profesor Kakarriqi, një komitet tjetër i cili drejtohet nga zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonja Rakacolli dhe komiteti i certifikimit dhe eliminimit të fruthit dhe të rubeolës. Mbledhja e fundit e këtij komiteti është bërë në datën 29 janar për të analizuar situatën aktuale.

Janë kryer 109 mijë e 562 vaksinime, nga të cilat mbi 48 mijë e 442 janë vaksinime të rutinës, sipas planeve mujore, që janë të planifikuara që në fillim të vitit për vitin 2018. Vaksinimet janë bërë për moshat nga 1 deri në 5 vjeç dhe mbi 61 mijë e 120 vaksinime janë

bërë jashtë rutinës, sikurse e përmendi edhe doktoresha Bino. Këto u takojnë personave të kontaktit apo individëve, të cilët rezultojnë me një dozë vaksine fruthi.

Nga ana tjetër, krahas përmirësimit të vaksinimit rutinë, pra vaksinimit në kohë të fëmijëve 1 deri në 5 vjeç Instituti i Shëndetit Publik ka kryer dhe po kryen vaksinime në disa grupe të tjera, sipas strategjisë së përcaktuar: vaksinimin për personat me datëlindjet 1980-1990 që janë me një dozë, iniciativë që ka filluar që në vitin 2016; po kështu, është bërë identifikimi i fëmijëve të prapambetur për kryerjen e vaksinimit të tyre, duke nxitur kërkimin me komunikim derë më derë, sepse nuk është e lehtë; takime me mjekët pediatër dhe me ata të konsultores, të cilët kanë sugjeruar shtyrjen e moshës së vaksinimi dhe trajnimit të tyre; është bërë evidentimi dhe plotësimi i skemës së vaksinimit me dy doza, vaksinë pas fruthit për të gjithë fëmijët; takime më përfaqësues të Komunitetit Mysliman, duke qenë se një pjesë e refuzimeve vijnë nga persona me besim fetar, për organizmin në kohë të komuniteteve; vaksinimi i popullatave rome, si kontingjent lëvizës që nuk është gjithmonë i kapshëm; vaksinimi i kontakteve të personave me fruth, sipas udhëzimeve përkatëse; vaksinim të popullatës kur ka vetëm një dozë të vaksinës.

Masat e kontrollit që janë ndjekur dhe janë duke u ndjekur janë: izolimi i personave të infektuar në pavijone të caktuara në pediatri dhe tek të rriturit dhe vetizolimi për rastet ambulatorë; masat standarde të kontrollit të infeksionit dhe transmetimit ajror; përdorimi i maskave nga personeli dhe pacientët kur shkojnë në ekzaminime; vaksinimi i personelit, monitorimi i gjendjes mbrojtëse të personelit ndaj fruthit; vaksinimi brenda 72 orëve i kontakteve; vendosja e survejancës aktive në QSUT dhe në nivel kombëtar; takime dhe trajnime me pjesëmarrjen e mjekëve të institucioneve parashkollore dhe shkollore, si dhe të mjekëve të familjes. Pikërisht për këtë arsye doktoreshë Bino kërkoi ndihmën dhe mbështetjen tuja, sepse fushata të tilla sensibilizuese janë të nevojshme.

Unë dua t'ju siguroj se nuk ka pasur aspak lëvizje në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sa i takon blerjes së vaksinave, përkundrazi, ka pasur shtesë të buxhetit dhe ju e dini shumë mirë këtë gjë, sepse është thënë edhe në diskutimet dhe seancat dëgjimore që ne kemi pasur për buxhetin e vitit 2019. Asnjëherë nuk ka munguar edhe sasia e vaksinave është sipas nevojave, por stigma për disa nëna apo për disa individë të caktuar, të cilët nuk pranojnë të bëjnë vaksinimin. Është një nga elementet që ka ndikuar negativisht dhe ne së bashku jo vetëm që bëjmë fushata sensibilizimi, por është shumë e rëndësishme që ta bëjmë prezente këtë gjë. Meqë është media këtu, është shumë e rëndësishme t'i ftojme të gjitha nënat të sjellin fëmijët në konsultore, me qëllim vaksinimin. Kjo është e detyrueshme dhe një masë paraprake për të parandaluar epidemitë. Natyrisht, nuk është një situatë e

degraduar, sepse janë marrë masat jo vetëm nëpërmjet informimit apo promoconit, por edhe masat për trajtimin e personave, të cilët në raste të caktuara kanë shenjat e fruthit. Në këtë kontekst, kërkoj mirëkuptimin që të gjithë bashkë të përdorim këtë seancë si një mundësi promovimi për vaksinimin kundër fruthit për të gjithë qytetarët, në mënyrë të veçantë për nënat. Por të jeni të sigurt për një gjë: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jo vetëm që merr raporte mujore, jo vetëm që i ndjek në vazhdimësi...

Petrit Vasili – Mujore janë shumë larg...

Merita Xhafaj – Javore, ndjesë, sepse unë ndjek edhe vetë.

Petrit Vasili – I shpjegoj edhe Silva të gjitha, Merita.

Merita Xhafaj – Në këtë kontekst, mendoj se nuk është momenti për të bërë debate të natyrave që janë jashtë profesionit.

Petrit Vasili – Zonja Xhafaj, e lëmë këtë pjesë të diskutimit. Kam vetëm një pyetje, për të cilën nuk mora përgjigje dhe lidhet me momentin e shpalljes së epidemisë. Po jua konkretizoj për t'ju shpjeguar se si funksionon kjo punë që ta kuptojnë edhe kolegët. Po marr shembullin e Maqedonisë fqinje. Më 1 janar ministri maqedonas, Venko Felipçe, doli publikisht dhe tha: “Është shpallur epidemia e fruthit në Shkup. Jemi të detyruar që nesër të ndërmarrim masën e përkohshme, ndalesa...”. Pra, ministri i Shëndetësisë së një vendi, që e njeh rregulloren sanitare, sepse ka autoritetin publik më të lartë, del dhe bën shpalljen e gjendjes epidemike. Ministria këtu nuk e ka bërë këtë gjë. Unë kam kërkuar publikisht që më 22 janar, por më 23-24 janar ka bërë komunikimin e parë. Këto janë të vërteta dhe nuk po bëj pyetje, se nuk ka çfarë përgjigje të ma japin.

E dyta, për ta mbyllur, Ministria e Shëndetësisë nuk i ka kursyer paratë për punë të tjera, por qytetarët shqiptarë nuk kanë parë as ndonjë spot intensiv që të jepet për të instruktuar fruthin. Kanë parë rikonstruksione, qendra shëndetësore që lyhen e patinohen, por nuk kanë parë një spot të tillë, që të jepet vazhdimisht, meqenëse dallojmë që po rritet stigma (zonja Bino e di, por është në një pozicion tjetër dhe nuk flet dot sot, që elementet e stigmës ne i kemi luftuar edhe vite më parë për të mbajtur gjithmonë mbulesa të larta vaksinimi), pra duhej të kishte spot të veçantë për stigmën dhe duhej të thuhej shqip se ai profesori anglez, që e ndezi këtë histori në botë, u tërhoq publikisht dhe kërkoi ndjesë përpara të gjithëve, sepse ishte një artikull, të cilin ju e dini se si është tërhequr. Pra, t'u jepen njerëzve edhe dy-tri elemente shtesë për t'i sensibilizuar lidhur me situatën. Ministria mund të mos i kishte kursyer paratë, sepse nuk i ka kursyer për gjëra të tjera. Njerëzit nuk kanë ku ta marrin këtë lloj informacioni. Kështu po bëhet kjo botë. Është gjithmonë e më shumë virtuale, përdoret televizioni, përdoren smartët që kemi nëpër duar. Ku janë këto? Nuk ka gjëra të tilla.

Megjithatë, vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar zonja Pampuri.

Orjola Pampuri – Profesori dhe profesoreshë Silva theksuan më parë se janë rreth 1400 raste të të prekurve nga fruthi deri tani dhe pjesa më e madhe, sikurse e theksoi doktoreshë Silva, janë fëmijë në dy vjeç. Për këta fëmijë nën dy vjeç a është bërë ndonjë studim dhe a ka ndonjë shifër se sa prej këtyre fëmijëve nuk vaksinohen për shkak të frikës së autizmit?

Për sa i përket promoconit, sigurisht spotet televizive dhe nëpërmjet fletëpalosjeve bëhet në bazë të një plani kombëtar, të cilin e ndërmarrin Ministria e Shëndetësisë, ISHP-ja, departamenti i promocionit, për ta shpërndarë më pas në DSHP-të e rretheve. Me sa di unë, nuk ka një promocion të tillë nëpërmjet palosjeve që shpërndahen në DSHP-të e rretheve. Gjithashtu, nuk ka një spot, i cili informon të gjitha ato nëna për risqet që mbart vaksina dhe mungesën e risqeve, pra vaksina është immune ndaj risqeve për autizmin, nuk ka lidhje me autizmin. Një pjesë e fëmijëve të pavaksinuar janë të atyre prindërve që kanë frikë për shkak të autizmit.

Kolegë tuaj theksojnë se numri i të prekurve nga fruthi është më i madh dhe, faktikisht, për shkak të prevalencës së lartë të të prekurve nga fruthi, jemi përballë një epidemie, por kjo është për Ministrinë e Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë nuk e pohon një situatë të tillë, nuk e merr një përgjegjësi të tillë. Pse nuk e bën një gjë të tillë? Faktikisht, kjo është në bazë të deklaratave që kanë dhënë kolegët tuaj: “Jemi përballë një epidemie”.

Ju faleminderit!

Petrit Vasili – Po, zonja Bode.

Edlira Bode – Faleminderit!

Doktoreshë Silva, unë do t’i kthehem edhe një herë asaj që thatë ju, por edhe profesori, pra që kemi një rënie të mbulimit vaksinal në zona të caktuara në Tiranë. Unë dua të kuptoj pse ka ndodhur dhe për sa kohë ka ndodhur kjo rënie e mbulimit vaksinal, pra cili ishte viti i fundit, kur ne i kishim garancinë që e kishim mbulimin optimal në Tiranë dhe kur e zbuluat se nuk e kemi më?

Pastaj ju folët për shkaqe. Mësuam se një nga shkaqet është mungesa e vullnetit të nënave për të vaksinuar fëmijët. Të gjitha këto masa për të ndryshuar këtë vullnet, kuptuam se jemi duke i ndërmarrë dhe vënë në zbatim.

A kemi ndonjë mundësi shtesë, në rast se nuk e ndërrojmë dot vullnetin e një nëne për ta vaksinuar fëmijën apo po kapitullojmë para këtij fakti?

E fundit: që kur ka filluar ndërhyrja juaj për të korrigjuar situatën, çfarë rezultatesh kemi, dhe si ka ndryshuar situata që nga koha kur filluam të reagojmë e deri më sot?

Faleminderit!

Petrit Vasili – Po, zonja Bino.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush e do fjalën? Po, zoti Kakarriqi.

Eduard Kakarriqi – Unë po ju përgjigjem juve, jo si pyetje, por në lidhje me shprehjen që thatë, se mjekë të ndryshëm pretendojnë se ka situatë epidemike këtë vit, aktualisht.

Së pari, në këtë rast po flas me kompetencë epidemiologjike. Fruthi në fund të dhjetorit dhe në janar, nisi pikërisht si një...

Petrit Vasili – Të këtij viti?

Eduard Kakarriqi – Të këtij viti. Nisi si një infeksion nozokomial, në kuptimin e plotë të fjalës, dhe përhapja e tij ka qenë pikërisht urgjenca pediatrie, në radhë të parë e mbi të gjitha, e QSUT-së.

Pra, mund të themi se kemi një shpërthim epidemik, një *outbreak* të lokalizuar pikërisht në urgjencën pediatrie të QSUT-së, që u bë si një rrezatim për të kapur kontaktet e këtyre fëmijëve, të cilët nuk ishin shtruar, por që vajtën në shtëpi kontaktet e afërta.

Rrjedhimisht, deri në momentin aktual, tani që po flasim, është gjashtëdhjetë, pesëdhjetë në fakt, se gjashtëdhjetë është shumë, numri i individëve të prekur nga fruthi, të sëmurë me fruth, që janë ekzaminuar dhe kanë rezultuar pozitivë për fruth. Përqindja më e madhe e tyre, sikurse thamë, janë fëmijë të moshave nën dy vjeç dhe të pavaksinuar ndaj fruthit, gjë që absolutisht nuk flet për një situatë epidemike në Tiranë. Këtë e them me përgjegjësi profesionale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në gjithë Shqipërinë jo e jo, por po flasim për Tiranën.

Petrit Vasili – Më fal, por le të biem dakord, Edi, se këtu na fute në një konfuzion të paparë. Ministria e Shëndetësisë, më 23 shkurt të vitit që lamë pas, ka deklaruar gjendjen e epidemisë dhe ka publikuar masat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si? Më 23 shkurt është bërë. Unë nuk i ndjek punët kështu siç i ndiqni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu, që të biem dakord me një marrëveshje fjale, ne nuk po bëjmë një raportim që lidhet me ditët e fundit. Thamë: ecuria e epidemisë, ku jemi e si po shkojmë. Meqë the se kemi outbreak, ne kemi outbreak sepse ende kemi një gjendje të pakontrolluar si duhet. Në këtë sfond lindin outbreak-et. Ti e di më i mirë se unë, por le t'ia kursejmë auditorit këtë lloj debati.

Silva Bino – Vjet është shpallur epidemia, siç e thatë, dhe natyrisht ne kemi njoftuar edhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë, sipas çdo rregulli, sepse nuk kemi pse të fshehim gjë.

Petrit Vasili – Jo pra, s'ka gjë për të fshehur. S'e thashë këtë gjë.

Silva Bino – Ne kemi interes të zbulojmë sa më shumë, dhe fakti që zbulojmë tregon se e kemi të rritur gjithë inteligjencën epidemike, në mënyrë që t'i kapim rastet që në fillim.

Petrit Vasili – Më 23 shkurt, Komiteti i Inteligjencës nuk ishte ngritur fare, zonja Bino...

Silva Bino – Jo, kjo është e vërtetë, e kemi të rritur inteligjencën në përgjithësi.

Petrit Vasili – Unë nuk dua të gjej asgjë të dobët tek ju, por...

Silva Bino – Unë po i përgjigjem pyetjes.

Petrit Vasili – Po s'ka, është e qartë.

Silva Bino – Po edhe pika të dobëta do të ketë.

Petrit Vasili – Unë nuk dua të evidentoj pikat e dobëta, por dua të evidentoj pikat e forta.

Silva Bino – Atëherë, për sa i përket këtij viti, kemi një dallim nga viti që shkoi, sepse kemi vetëm një shpërthim të kufizuar, siç e tha edhe Edi, që lidhet kryesisht me QSUT-në. Nuk kemi përhapje në të gjithë vendin. Kjo ka ardhur si pasojë e të gjitha këtyre fushatave të vaksinimit.

Petrit Vasili – Dakord!

Silva Bino – Pse nuk ka më raste në Kukës? Pse nuk ka më raste në Fier? Pse nuk ka më raste në rrethe të tjera? Pra, e gjithë kjo është një pasqyrë e qartë e asaj që ka ndodhur.

Për sa i përket gjendjes në Tiranë, në lidhje me pyetjen që bëri zonja, gjendja në Tiranë ka disa vite që monitorohet. Natyrisht, Instituti i Shëndetit Publik është ai që monitoron, po përpara tij ekziston Drejtoria e Shëndetit Publik të Tiranës, e cila përgjigjet direkt për mbulimin vaksinal për kontrollin e vaksinimit në vend.

Që nga viti 2016, ne kemi udhëzuar Drejtorinë e Shëndetit Publik të Tiranës, që të fillojë marrjen e masave përkatëse, duke punuar në çdo komunitet, sepse grupet janë të ndryshme. Një pjesë e grupit janë prindërit intelektualë, siç ka qenë nëna ime, e cila nuk më ka vaksinuar mua nga fruthi, që jam një e mbijetuar e fruthit, ose njerëz të cilët pretendojnë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e vërtetë, të vërtetën po them. Jo vetëm aq, por njerëz që pretendojnë se me ushqimet e mira, vaksinimi nuk duhet më. Vaksinimi është viktimë e suksesit të vet. Pra, nuk kishim fruth kaq vite, aq sa mjekët e familjes nuk e njihnin fruthin, pavarësisht se sa i trajnonim

ata. natyrisht, këtu bëjnë pjesë edhe grupe fetare, të cilët nuk duan të vaksinohen. Është një pjesë e Komunitetit Mysliman, jo të gjithë, por një pjesë tyre, me të cilët jemi munduar të bëjmë kontaktet tona, duke punuar me gratë myslimane apo me persona të tjerë.

Pra, ne kemi filluar t'i ndërtojmë strategjitë tona sipas komuniteteve më të cilët punojmë. Unë përmenda mjekët, sepse ata janë një element tepër i besueshëm. Koha që mjekët duhet të shpenzojnë me personin që pret të vaksinohet apo të marrë edhe shërbime të tjera të kujdesit shëndetësor, duhet të jetë ajo e duhura. Pra, mesazhi duhet të jetë ai i duhuri.

Për sa i përket pyetjes tjetër, që është një pyetje shumë e saktë, tek ne vaksinimi nuk është një vaksinim i detyruar. Është i bazuar në vendime të mirinformuara, ama bëhet i detyruar, sepse para se të shkosh në çerdhe, në kopsht, në shkollë, duhet të jesh i pajisur me kartelën e vaksinimit. Edhe këtu ka çaluar puna në disa raste. Është e vërtetë që ka çaluar. Një nga masat e marra gjatë gjithë kësaj periudhe ka qenë vërtetimi dhe identifikimi i të gjitha kartelave të fëmijëve në çerdhe, kopshte, në mënyrë që të ishim të sigurtë që ky proces po funksiononte ashtu siç duhet. Pavarësisht se ti merr një vendim të informuar, ke edhe një balancë ligjore, e cila të frenon në lidhje me lirinë tënde, sepse liria jote përfundon aty ku fillon liria ime.

Kjo ishte, pak a shumë.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Po, Floida!

Floida Kërpaçi – Përshëndetje!

Së pari, ju falënderoj për gjithë ekspozenë që na bëtë. Pa diskutim, të gjithë jemi të qartë se përhapja e fruthit me shpejtësi dhe brenda një periudhe të shkurtër kohore, është një tregues i qartë i mungesës së politikave mbrojtëse ndaj sëmundjeve infektive në vend. Jo vetëm kaq, por dallojmë qartazi edhe një shkelje ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, në të cilin parashikohen masa të veçanta që duhen marrë. Konkretisht, siç thuhet në nenin nr. 7: “masa për izolimin e këtyre rasteve”.

Në fakt, po t'i referohemi asaj që kemi parë, rasteve që janë denoncuar nga nëna të ndryshme dhe thirrjeve që kanë bërë autoritetet, është thënë që në dispozicion të këtyre fëmijëve të prekur të vihet jo vetëm kati i tretë, por dhe dhomat e spitalit të pediatriisë, pra Spitali i Pediatriisë të jetë i hapur për të gjitha këto raste, duke shkelur në këtë mënyrë ligjin konkret, që sanksionon dhe detyron për izolimin e këtyre rasteve. Kjo situatë, ndryshe nga sa thotë protokollin i sëmundjeve infektive, e shkelin këtë protokoll.

Megjithatë, pyetja ime është kjo: për të përmbushur këtë detyrim ligjor, çfarë mase është ndërmarrë dhe do të ndërmerret nga institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos kemi më një shkelje të ligjit, siç është konstatuar dhe vërtetuar?

Petrit Vasili – Në rregull!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetje tjetër?

Floida Kërpaçi – Jo, më pyeti se kush e ka konstatuar.

Petrit Vasili – Po.

Floida Kërpaçi – E para, ka raste që janë bërë publike nga nëna të ndryshme, por edhe vetë autoritetet kanë bërë thirrje dhe kanë treguar se në dhomat e pediatriisë është pritur për ardhjen e tërë këtyre rasteve. Siç e shpreha edhe më parë, këtu kemi të bëjmë qartazi me një shkelje, dhe nuk po veprohet sipas protokollit të sëmundjeve infektive, ku fëmijët e prekur duhet të jenë të izoluar. E tha edhe zonja më përpara, se këto raste i kemi të lidhura edhe me kujdesin spitalor. Pra, janë shtuar rastet e lidhura me kujdesin spitalor.

Ligji konkret, neni 7 i tij, që unë e kam përpara, por mund ta lexoje dhe për ju, thotë se masa e veçantë që duhet ndërmarrë është edhe izolimi. Pyetja ime konkrete është: çfarë mase ndërmarrin institucionet përkatëse për të parandaluar dhe moslejuar shkeljen e këtij ligji?

Faleminderit!

Petrit Vasili – Po, zonja Pampuri, shkurt.

Orjola Pampuri – Në situata të tilla, një rol të rëndësishëm ka epidemiologu. Tani, si është situata e mjekëve epidemiologë nëpër rrethe? Jam shumë kurioze ta di, sepse duke qenë se ka mungesë të mjekëve specialistë në rrethe, besoj se edhe problematikat me epidemiologët do të jenë të njëjta. Kjo është për Ministrinë e Shëndetësisë. Në situata të tilla, mjeku epidemiolog është ai që mban përgjegjësinë më të madhe në rrethe. Si është situata e mjekëve epidemiologë në rrethe? E di përgjigjen, por dua të bëhet publike.

Merita Xhafaj – Unë po flas jo nga pikëpamja e ekspertizës, sepse natyrisht, janë të ndara ca pozicione, por në përgjigjen që lidhet me zbatimin e ligjit, unë nuk e di të ketë ndonjë akt verifikimi, që ndodhin këto gjëra. Më vjen shumë keq që bëhen pyetje të tilla. Ne jemi të hapur për të gjithë deputetët që duan të shikojnë situatën konkrete, qoftë në regjim hospitalizimi, qoftë në atë ambulator. Jemi shumë të hapur që t'i shoqërojmë, që të mund ta shikojnë konkretisht.

Këtu nuk është çështja që thjesht të flasim në tryezë, nga larg, se ka pasur një apo dy ankesa. Jemi të gatshëm t'i verifikojmë në terren. Është e pamundur të ndodhë kjo që thoni ju, sepse natyrisht ka dhoma të përcaktuara jo vetëm sipas ligjit, por dhe sipas protokollit të klinik,

për trajtimin e të sëmurëve të infektuar. Jo vetëm që ka pavione, por edhe brenda pavioneve të tjera apo shërbimeve të tjera ka dhoma, të cilat përdoren për sëmundje të tilla infektive, në raste nevojë.

Lidhur me pjesën e mjekëve epidemiologë, realisht, në shërbimin parësor ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – Pyetja është një çikë jashtë objektit të ditës. Në qoftë se s'keni informacion të saktë, nuk kemi nevojë të dëgjojmë gjëra aproksimative. Nuk është ky informacion, nuk e keni për momentin, s'jeni të detyruar ta keni sot, sepse jemi për një çështje tjetër, kështu që nuk ka ndonjë keqkuptim në këtë mes.

Merita Xhafaj – Numrin e saktë të shtrirjes së mjekëve mundet t'jua vëmë në dispozicion, sepse në shëndetin publik natyrisht që ka. Për pjesën teknike pastaj...

Silva Bino – Jo. Doja të sqaroja se pavarësisht rekomandimeve për izolim, për sa i përket izolimit të fruthit, kur është diagnostikuar ose dyshuar, ka pasur kate ose segmente të spitalit infektiv në pediatri ose edhe pavione të tjera, të cilat janë vënë në dispozicion. Shpeshherë ka edhe një plan përkatës nëse ka numër apo shtesë rastesh. Këto janë plane të përgatitura prej vitesh, të cilat vihen në zbatim në kohë epidemish. Ju ndoshta ngatërroni elementin gjatë pranimin të urgjencës pediatrike. Aty ne kemi pasur shpërthimin epidemik, atë që përmendi edhe doktori.

Petrit Vasili – Zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Unë kam një pyetje për profesor Kakarriqin.

Ju thatë se drejtoni komitetin e ekspertëve, i cili është mbledhur në mënyrë të vazhdueshme dhe deri tani, të paktën për vitin 2018, thamë që kemi 1 mijë e 360 raste të diagnostikuara. Ka ndonjë parashikim nëse për këtë vit ky numër do të jetë më i lartë apo jo, bazuar në incidencën e janarit? Numri që foli profesoreshë Silva për mbulimin ose vaksinat që janë blerë, mendoni se janë të mjaftueshme edhe në vazhdim?

Eduard Kakarriqi – Për sa i përket pyetjes së dytë, mendoj se po.

Për sa i përket pyetjes së parë them se nuk do të ketë rritje të numrit të rasteve, sepse 1 mijë e 360 raste janë nga muaji dhjetor i vitit 2017 deri në momentin që flasim tani dhe për këtë vit janë vetëm 50 raste. Trendi tregohet qartë, u tregua qartë edhe vjet. Këtë vit ishte, sikurse e thashë, vetëm një **out brake** që ndodhi në QSUT. Sipas të dhënave, rastet janë në ulje.

Petrit Vasili – Kam një pyetje të karakterit teknik.

Duke qenë se kemi pasur të bëjmë me kontingjente të viteve 80-90, që janë të pavaksinuar, llogaritja është që mungon doza e dytë, siç ka qenë informacioni që keni bërë publik. Më korrigjoni nëse informacioni që keni bërë publik nga ministria nuk është i saktë dhe

unë e tërheq pyetjen. Nëse është i saktë, do të vazhdoj të bëj komente. Më thoni njërën ose tjetrën. Është boshllëku i atyre që në periudhën e viteve 80-90 nuk e kanë bërë dozën. Është bërë publike dhe janë ftuar të bëjnë dozën. Ky është fakt.

Po të nisemi me llogaritje, llogaritjet e kësaj fashe imponojnë një numër njerëzish shumë më të lartë nga ç'janë parashikimet tuaja për vaksinim. Ky është fakt.

Një fakt tjetër është që një pjesë e këtyre njerëzve nuk ndodhen në Shqipëri dhe në momentin e një epidemie, një nga elementet e tjera që aktivizohet, megjithëse janë popullata me risk, kur ka lëvizje të mëdha, siç janë momentet e pushimeve, ka plot kontingjente shqiptarësh, që e kanë këtë problem, të cilët vijnë në Shqipëri. Ky kontingjent ka qenë jashtë vëmendjes suaj, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk janë sugjeruar kurrë. Nuk ka asnjë ...

Doni t'ju jap filmimet e reporteve tona? Ku do ta marrin informacionin? Ju nuk u shkonin në shtëpi. Informacioni dihet se ku merret.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos më kundërshto në situatë epidemie. Aty bëhet informacioni. Madje, në situata të tjera ti e di që ne e kemi pasur zakon që bashkë me kontrollin e pasaportës u jepet edhe fletëpalosja përkatëse me informacion, sepse janë të rriskuar. Në rast se ne nuk e bëjmë në mënyrë komplekse, do të jemi vazhdimisht ...

Edi është optimist, por unë nuk jam. Ti, Edi, e di që ne nuk i kontrollojmë dot **out brake**-t, mund të jenë të çdo lloji natyre, por, e para, nëse situata është gjithmonë e alertuar, mund ta ketë këtë gjë.

E dyta, ne kemi një komision ekspertësh, që ka një emër të caktuar, për çrrënjosjen e këtyre. Objektivi i Organizatës Botërore, ku ne bëjmë pjesë, është të çrrënjosim, jo të kemi raste. Pra, t'i sqarojmë që ky është objektivi strategjik. Në një situatë ku ka gepe, ku ka popullata të tilla, që lëvizin, hyjnë dhe dalin, ne nuk po ju kritikojmë, por duhet ta merrni seriozisht në konsideratë, sepse do të kemi një situatë vazhdimisht fluktuante në këtë drejtim, do të jemi edhe të qetë, por edhe të shqetësuar dhe do të ndodhemi para ngjarjeve që nuk i parashikojmë dot.

Atëherë, çfarë bëhet me këta? Epidemia ka vetëm një mekanizëm. Gjerësisht shtrirje të efektit, gjerësisht shtrirje të komunikimit dhe brenda mundësive, në këtë rast, kur instrumenti ekziston, që është vaksinimi, edhe gjerësisht shtrirje e vaksinimit. Në këtë pikëpamje, nga leximi që bëjmë, kemi disa momente që mund të administrohen edhe më mirë. Këtu nuk ka

asnjë element, as për t'u mërzhitur, as për t'u zemëruar. Në fund të fundit, rastësia ka bërë të jemi familjarë me këtë gjë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin. Nuk kemi asnjë gjë të keqe.

Kush do të flasë?

Po, zonja Duma.

Grida Shqina Duma – Faleminderit!

Në ekspozenë tuaj ju thatë se nuk kemi raste në Kukës, kemi raste në Tiranë. E shtroj këtë, sepse diagnoza e problemit është fillimi i zgjidhjes së problemit. Nëse ju nuk bëni një analizë minimaliste demografike të vendit, nuk jeni duke shkuar askund. Nëse jeni duke u thënë shqiptarëve apo vetes suaj që qarku i Kukësit, më i varfri në Shqipëri, është më i ndërgjegjësuar për vaksinën se qarku i Tiranës, unë sigurisht, edhe si njohëse e një tjetër profesioni që nuk është juaji, sepse e njoh çfarë do të thotë të bësh diagnozë popullate për shumë probleme, jo vetëm për shëndetësinë, ju them se qarku i Kukësit ka ikjen më të madhe të popullatës. Sigurisht, sepse ka ikjen më të madhe të popullatës, na shkon arsyeja të themi se këtu ka më pak raste sëmundjesh, sepse nuk ka njerëz. Sëmundje nuk mund të ketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pa diskutim. Nëse ju ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ju them edhe një herë shkaqet në makro.

Petrit Vasili – Më falni, merrni fjalën kur doni të sqaroheni. Mos e ndërprisni deputeten!

Grida Shqina Duma – Nëse ka një ose nuk ka një, ju thoni se ka ndërgjegjësim, kur ne e dimë që nuk ka. Marrëveshjen e fjalës unë nuk ...

Petrit Vasili – Silva, mos ndërhy! Merre fjalën kur të duash, por nuk jemi në pazar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Duma, mbaruat?

Grida Shqina Duma – Jo.

Petrit Vasili – Nuk ka mbaruar zonja Duma. Mos e ndërpre! Kur të flasësh ti, do të dëgjojnë me vëmendje. Ky është minimumi i etikës.

Grida Shqina Duma – Ju me të drejtë dhe mirë e bëni, e përdorni edhe momentin e mikrofonit ose të kamerës për të ndërgjegjësuar popullatën që autizmi nuk vjen si pasojë e vaksinës së fruthit, dhe shumë mirë ...

Petrit Vasili - E asnjë vaksine.

Grida Shqina Duma – Meqenëse ishim duke folur për fruthin.

Ndërkohë, unë ju them edhe diçka tjetër. Përdoreni sallën e komisionit edhe si një ndërgjegjësim që përfaqësoni, megjithëse jeni specialist të mirëdëgjuar nga popullata, sepse keni një tagër të mirë profesional, veçanërisht ju të tre, njerëzit ju ndjekin si profesionistë, përveçse si përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, edhe për të treguar që jeni të ndërgjegjësuar që shëndetësia nuk është lumturia që paraqisni ju, sepse kemi qenë në të gjitha seancat në komision dhe nuk u kemi dëgjuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petrit Vasili - Nuk ka lidhje me ty. Mos fol për çdo gjë!

Grida Shqina Duma – Po, mos fol për çdo gjë!

Pra, pasi ju themi që keni edhe tagër profesional, mos ndërhyjni për çdo gjë. Nuk kemi dëgjuar një herë përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë që të vijin këtu dhe të thonë se kanë probleme. Shëndetësia është sektori më problematik për të gjithë shqiptarët, por ju që e përfaqësoni nuk thoni një herë të vetme që keni probleme. Si mendoni se do t'i zgjidhni problemet kur nuk pranoni? Ju vazhdoni të thoni se Kukësi ka ndërgjegjësim më të lartë se Tirana. Sërish po jua them profesionalisht, Tirana mbetet qarku i vetëm ku ka lëvizje migratore, që vijnë nga rrethet. Arsyeja e parë, që ju nuk e mbulon dot, as me ndërgjegjësim, është se ju nuk keni në kontroll lëvizjet migratore dhe kjo duhet diskutuar këtu. Më pas është elementi i marketizimit të problemit ose i bërjes së spoteve, dakord? Në këtë kuptim, të diagnostikojmë problemin dhe jo ta çojmë fitoren atje ku nuk ka, sepse atje ka humbje, ka ikje popullate dhe ka ardhje popullate në Tiranë. Ardhja e popullatës në Tiranë duhet të ketë një parandalim dhe një parashikim, sa njerëz po vijnë, pse po vijnë, me çfarë shkollimi, me çfarë dijenie, ku jetojnë, në çfarë kushtesh jetojnë dhe më pas ju të parandaloni dhe të shikoni, sepse de facto, duke thënë që nuk ka raste në Kukës, por ka raste në Tiranë, jeni duke e kthyer diagnozën e problemit në të kundërtën. Kukësi nuk ka, sepse ka rrjedhje popullsie. Tirana mund të ketë më shumë, sepse ka ardhje popullsie. Në këto kushte, ardhja e popullsisë duhet përqendruar shumë më tepër, propaganda, spoti, ndërgjegjësimi, në atë...

Silva Bino – Niveli i ulët është te lagjet intelektuale të Tiranës, jo te lagjet e tjera.

Grida Shqina Duma – Ky është diskutim që ne hapim...

Klodiana Spahiu – Mund të bëj një ndërhyrje të vogël?

Petrit Vasili – Po.

Klodiana Spahiu – Unë kam një kërkesë edhe ndaj jush.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem!

Është e disata herë që në komision na ndodh të mos përdoret etika ndaj të ftuarve. Si nënkryetare e komisionit kërkoj që, e para, është e vërtetë që ne jemi deputetë, por nuk është e thënë që i dimë të gjitha.

E dyta, po flasim me profesionistë që kanë mbi 20 e ca vjet karrierë në atë institut. Nëse unë e kam gabim, më korrigjoni.

Petrit Vasili – Kanë 35 vjet ose më shumë.

Klodiana Spahiu – 35 vjet.

Petrit Vasili – Edi ka 40 vjet.

Klodiana Spahiu – 40 vjet. Është profesor, shkruan libra, na ka mësuar ne të gjithëve këtu dhe ne të themi se ju e dini, ju nuk e dini, nuk më duket normale. Edhe që t’u drejtohem i në emër të ftuarve, nuk më duket normale.

Ne vijmë këtu për të respektuar njëri-tjetrin, e para.

E dyta, kjo seancë dëgjimore ka rol kryesor ...

Petrit Vasili – Si u drejtohem i në emër? Si t’u drejtohem i Pa emër?

Klodiana Spahiu – Ju lutem, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Me mbiemër. Po, keni të drejtë. E kam bërë unë gabim. Të më falni!

Më falni, zonja Bino, nuk do t’ju them më Silva.

Klodiana Spahiu – Miqësinë tuaj me doktoreshë Binon prej 30-40 vjetësh, sa kohë keni ju miqësi ...

Petrit Vasili – 50 vjet, nuk mbahet mend që kur e njoh.

Klodiana Spahiu – 50 vjet, nuk mbahet mend. Nuk është e thënë që ne t’i drejtohem i ...

Petrit Vasili – Edhe Halimi e di, sepse e ka pasur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë krushqit e tu.

Klodiana Spahiu – Nuk është etike t’u drejtohem i me shprehjet “gënjeni ose jo për shifrat”. Ne duhet të jemi realistë dhe të pranojmë një fakt.

Petrit Vasili – Nuk tha njeri që gënjejnë.

Klodiana Spahiu – Ju lutem, të mbaroj!

Petrit Vasili – Nuk tha njeri që gënjejnë. Për kë e ke fjalën? Vendors adresorët!

Klodiana Spahiu – Ne jemi në seancë dëgjimore për të bërë pyetje dhe për të dëgjuar zërin e atyre që kanë më shumë se 30 vjet pune. Ju këtë gjë e dini shumë mirë. Sesa mirë e dinë ata dhe ju, që keni qenë atje, nuk e di asnjë nga ne të tjerët këtu.

Petrit Vasili – Jo, është debat i hapur.

Klodiana Spahiu – Debati është i hapur, por është edhe çështje profesionale.

Të nderuar kolegë, unë edhe një herë do t'ju kërkoja që për çështje shumë specifike, të mundohemi të respektojmë të ftuarit edhe nëse kanë informacione që ne nuk na shkojnë për shtat. Të jeni të bindur që profesorët, të paktën këta që kanë ardhur sot, kanë qenë në të gjitha kohët politike, edhe kur ne nuk kemi qenë të përfshirë në politikë, por në profesionet tona. Prandaj, të nderuar, të mundohemi t'i dëgjojmë. Më pas, nëse kemi komente, mund t'i bëjmë, por edhe duke respektuar të ftuarit.

Faleminderit!

Petrit Vasili – E qartë.

Ka ndonjë plotësim të fundit për të bërë?

Zoti Pendavinji, do të bësh pyetje?

Eduart Kakarriqi – Në fakt, do të doja të shtoja diçka.

Për atë që thatë ju ...

(Ndërhyrje pa mikrofoni.)

Petrit Vasili – Ti bën sugjerime të kësaj natyre dhe pret ...

Unë për instinkt, për humor, do ta kthej.

Eduart Kakarriqi – Doja të thosha dy momente.

Petrit Vasili – Po.

Eduart Kakarriqi – Në vitin 2000 është bërë vaksinimi masiv i moshave 12 muaj deri në 14 vjeç kundër fruthit dhe rubeolës me synim, në atë kohë, për eliminimin e fruthit në vitin 2007 në vendin tonë.

Petrit Vasili – Për çrrënjosjen.

Eduart Kakarriqi – Kjo do të thotë se datëlindjet e viteve 1986 e më pas e kanë marrë dozën e fruthit në vitin 2000.

Nga ana tjetër, kujtoj që në vitin 2001 u bë një *check up*, që zgjati deri në vitin 2002, sërish me fruth-rubeolë, për të gjitha femrat e moshave 15-39 vjeçe për mbrojtjen ndaj rubeolës.

Problemi qëndron se grupmoshat e vendit tonë kanë në përgjithësi një mbrojtje të mirë pasvaksinore kundrejt fruthit. Xhepa reseptivë ka dhe është e vështirë të gjenden, pasi janë të paidentifikueshëm. Unë bie plotësisht dakord me zonjën Duma, që tha se Tirana me të vërtetë është një *locus minoris resistente*, sepse është metropoli i vendit tonë, ku ka hyrje-dalje masive. Në një pallat të ri, këtë e them me bindje të plotë, absolutisht duhet një kohë jo e vogël për të ditur situatën vaksinore të fëmijëve që kanë ardhur rishtaz në atë shtëpi prej 12-15 katesh. Pra, del një superdetyrë e personelit shëndetësor të vendit tonë, por që kërkon patjetër ndihmën edhe

të personelit tjetër, të punonjësve socialë. Prandaj, në këtë mes gjej rastin të bëj një thirrje të ndërlidhjes së rrjetit shëndetësor me rrjetin social për zgjedhjen e problemeve që flasim.

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Kakarriqi!

Zoti Kosova, urdhëroni!

Halim Kosova – Sa i rëndësishëm është vaksinimi dhe sa i rëndësishëm është sqarimi i personelit mjekësor dhe atyre që bëjnë vaksinën?

Ju më sollët ndër mend vaksinën për fruth-rubeolën, ku nëse do të shikoni grafikut e lindshmërisë, pas atij vaksinimi Shqipërisë i mungojnë 20-25 mijë fëmijë të porsalindur. Mbajeni mend këtë! Pse? Për një paragraf shumë të vogël, që nuk iu sqarua nënave gjatë këtij vaksinimi, që nëse gabimisht ti do ta kesh bërë vaksinën, kur nuk e dije që je shtatzëne, sepse mund ta kesh bërë 2 ditë pasi ke ngelur shtatzëne dhe nuk e ke ditur, kjo shtatzëni nuk duhet ndërprerë. U vërsulën drejt reparteve të aborteve gra të tmerruara nga informacioni i gabuar ose nga mungesa e informacionit. Që të jemi të ndërgjegjshëm, në momentin e parë unë jam ballafaquar me një sulm të tmerrshëm në këtë drejtim: “çfarë të bëj, ta heq apo ta mbaj, sepse më thonë ta heq”? Tek Akademia Amerikane e Obstetrikës-Gjinekologjisë, faqja 432 majtas, kapitulli i fundit, e mbaj mend si sot, thotë: “Duhet sqaruar popullata që të mos e bëjnë vaksinën nëse janë shtatzënë, në fillimet e saj, por në rast se gabimisht e bën, nuk duhet ndërprerë shtatzënësia. Kjo ka qenë një luftë e tmerrshme, edhe në institucionin që drejtoja, që një sy dhe mendjen duhet ta kisha te reparti i abortarit, se kanë dalë gra, të cilat i kam zbritur nga kaluqi dhe sot e kanë fëmijën gjallë, ashtu sikurse di akoma rate, i kam në memorien time, që për hir të një aborti, qoftë edhe fëmija i parë, sot e kësaj dite nuk ka fëmijë. Dua të them se ky është një shembull shumë i thjeshtë, që e kam kaluar vet në kurriz në atë periudhë, që sa i rëndësishëm është sqarimi i popullatës, sqarimi i personelit mjekësor, që të shpëtojmë jetë njerëzish dhe vaksina të mos kthehet në pakësim të numrit të lindjeve, por përkundrazi, për fëmijë më të shëndetshëm. Sa herë të diskutojmë për veprime, për mënyrën e organizimit apo se si ta bëjmë më mirë punën, dijeni qartë se do të mbrojmë jetën e qytetarëve, do të mbrojmë jetën e fëmijëve dhe do të shpëtojmë jetë.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit!

Keni komente të mëtejshme? Nuk ka.

Faleminderit të ftuarve!

Nesër në orën 10:00, sipas kalendarit, kemi dëgjesën për çështjen e modernizimit dhe informacionit për ndihmën ekonomike dhe asistencën sociale.

Dakord?

Ministria është e njoftuar.

MBYLLET MBLEDHJA